

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BELESOVA 1 " SH.P.K.**

Sot me date 28/04/2007 ne kerkuesit:

1. Ylli Ramadan Hysenbelliu I datelindjes 11.02.1962 banues ne Kuçove lagja 11 Janari, banese private (prane ish Fabrikes se perpunimit te naftes), I paisur me certifikat personale me foto nr 7/14 dt 06.03.2007
2. Fecorr Yzejdin Sado i datelindjes 06.11.1978, banues ne adresen e mesiperme, i paisur me certifikat personale me foto qe mban nr 11-65 dt 27.04.2007

Ne marreveshje te plote me njeri -tjetrin duke shprehur vullnetin tone te lire

Kerkojne te regjistrojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **"BELESOVA 1" shpk** vendosem te Themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, e cila do te kete emertimin e saj **"BELESOVA 1 " SH.P.K.**

Neni 1

Emertimi i Shoqerise Shoqeria do te kete emrin e saj tregetar "BELESOVA 1" SH.P.K

Neni 2

Forma juridike

Shoqeri" **"BELESOVA 1" SH.P.K.** do te kete formen juridike te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria eshte person juridik i themeluar sipas se drejtes shqiptare. Ajo zhvillon veprimtarine e vet ne perputhje me legjislacionin shqiptar, dispozitat e statutit dhe te Aktit te Themelimit.

Neni 3

Vula e Shoqerise

Shoqeria do te kete vulen e saj permbajtja e se ciles do te jete si vijon:
"BELESOVA 1" SH.P.K Ne te gjitha aktet ose dokumentat qe do te nxjerre shoqeria, shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar, vlera e kapitalit themeltar dhe administratori.

Neni 4

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Kuçove, lagja « 11 Janari », banese private (prane ish Fabrikes se Perpunimit te Naftes)
Ndryshimi i qendres se selise se shoqerise brenda juridiksionit te rrethit te Tiranës kryhet me vendim te Asamblese se Ortakeve .

Ndryshimi i selise jashte rrethit behet me vendim te asamblese se ortakeve dhe duhet te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Punime Montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise
- Centrale hidraulike - prova me ngarkese
- Centrale termike - prova me ngarkese
- Impiante per prodhimin e energjise nga burime alternative
- Instalime per n/stacionet - kabinat e transformatoreve - linjat e TN. e te mesem.
- Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te T.U. linjave per telefoni, radiotelefoni, televizive citofoni - mirembajtja e tyre.
- Ne fushen e ndertimeve rrugore, punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore
- Import - Eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem, te te gjitha llojeve, me shumice e pakice te lejuara nga Ligji.
- Transport mallrash Brenda dhe jashte vendit

Neni 6

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Neni 7

Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke.

Ortaket marin pjese ne kapitalin themeltar te shoqerise ne baze te kuotave te tyre respective te cilat jane te barabarta si me poshte:

1. Ylli Hysenbelliu ka 50% te kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise.
2. Fecorr Sado ka 50% te kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise.

Kapitali fillestar i shoqerise mund te zmadhohet edhe me kontributet ne natyre.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit fillestar te shoqerise behet me vendim te Asamblese se ortakeve. Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te ulet me poshte se shumata 100 000 (nje qind mije)leke.

Transferimi i kuotave te pjesemaries ne kapitalin e shoqerise behet me akt-noterial duke ushtruar fillimisht te drejten e parablerjes kundrejt ortakëve

Neni 8

Organet Drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- **Asambleja e ortakëve.**
- **Administratori.**

Administrator te shoqerise jane: Z.Ylli Hysenbelliu dhe Z. Fecorr Sado.

Neni 9

Zgjidhja e Mosmarveshjeve

Cfaredo mosmarveshje qe mund te linde midis ortakëve (ose trashegimtareve te tyre) ose me organet e shoqerise, lidhur ne interpretimin dhe ekzekutimin e ketij akti Themelimi apo Statuti,ose qe te lidhet ne cdo menyre me mardheniet e shoqerise, duke perjashtuar vetem ato qe sipas ligjit nuk mund te perbejne objekt mosmarveshje do te paraqitet per shqyrtim ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 10

Marredheniet ne Shoqeri rregullohen me dispozitat e Aktit te Themelimit, dhe statutit.

Vendimet e Asamblese se Ortakëve dhe Administratoreve, te cilat ne cdo rast duhet te jene ne perputhje me ligjin. Per ceshtje qe nuk jane parashikuar ne Statut dhe Aktin e Themelimit do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Kjo kontrate themelimi eshte hartuar ne kater kopje me vlere te barabarte ne gjuhen shqipe.

Per regjistrimin e shoqerise perdoret nje kopje e cila ka perparesi ligjore. Per sa me siper ortakët rane dakort dhe nenshkruan.

ORTAKET E SHOQERISE

Ylli Hysenbelliu

Ylli Hysenbelliu


FECORR SADO

Fecorr Sado

Fecorr Sado

FECORR SADO

Fecorr Sado



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BELESOVA 1" SH.P.K.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BELESOVA 1" SH.P.K. eshte themeluar ne baze te aktit te themelimit nga :

1. Ylli Ramadan Hysenbelliu i datelindjes 11.02.1962 banues ne Kuçove lagja 11 Janari, banese private (prane ish Fabrikes se perpunimit te naftes), I paisur me certifikat personale me foto nr 7/14 dt 06.03.2007

2. Fecorr Yzejdin Sado i datelindjes 06.11.1978, banues ne adresen e mesiperme, i paisur me certifikat personale me foto qe mban nr 11-65 dt 27.04.2007

te cilet ketu e me poshte do te njihen si **ORTAKET E SHOQERISE.**

Kjo shoqeri ne perputhje me legjislacionin shqiptar ,me ligjin nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare , " krijohet nga ortaket e kesaj shoqerie per te ushtruar veprimtari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut.

Kapitulli I Dispozita te Pergjitheshme

Neni 1

Forma e Shoqerise

Shoqeria ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet nga pese ortaket e mesiperme qe perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne Kapitalin Themeltar. Veprimtaria e shoqerise dote rregullohet nga ky statut,nga dispozitat perkatese te ligjit nr.7638 date 19.11.1992" Per shoqerite tregetare " si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi .

Shoqeria do te filloje te veproje si person juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin Tregetar te Shoqerive Tregetare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,ndersa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin ne organet tatimore.

Neni 2

Emertimi i Shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "BELESOVA 1" SH.P.K.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra , emertimi i shoqerise do te ndiqet menjehere nga inicialet " SHPK" .

Neni 3

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Kucove, lagja « 11 Janari » banese private (prane ish Fabrikes se Perpunimit te Naftes).

Ndryshimi i qendres se selise se shoqerise brenda juridiksionit te rrethit te Tiranes kryhet me vendim te Asamblese se Ortakeve .

Ndryshimi i selise jashte rrethit Tiranes do te behet me vendim te asamblese se ortakeve dhe duhet te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet .

Neni 5

Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Punime Montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise
- Centrale hidraulike - prova me ngarkese
- Centrale termike - prova me ngarkese
- Impiante per prodhimin e energjise nga burime alternative
- Instalime per nenstacionet - kabinetat e transformatoreve - linjat e TN. e te mesem.
- Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te T.U. linjave per telefoni, radiotelefoni, televizive citofoni - mirembajtja e tyre.
- Ne fushen e ndertimeve rrugore, punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore
- Import - Eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem, te te gjitha llojeve, me shumice e pakice te lejuara nga Ligji.
- Transport mallrash Brenda dhe jashte vendit

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke.

Ortaket marin pjese ne kapitalin themeltar te shoqerise ne baze te kuotave te tyre respective te cilat jane te barabarta si me poshte:

1.Ylli Musabelliu ka 50% te kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise.

2.Fecorr Sado ka 50% te kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise.

Kapitali fillestar i shoqerise mund te zmadhohet edhe me kontributet ne natyre.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit fillestar te shoqerise behet me vendim te Asamblese se ortakeve. Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te ulet me poshte se shuma 100 000 (nje qind mije)leke. Transferimi i kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise behet me akt-noterial duke ushtruar fillimisht te drejten e parablerjes kundrejt ortakeve

Kapitulli II **Administrimi i shoqerise** **Neni 7**

Organet Drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- **Asambleja e ortakeve.**
- **Administratoret**

Administratoret e shoqerise jane Ylli Hysenbelliu dhe Fecorr Sado

Neni 8 **Asambleja e ortakeve**

Asambleja e ortakeve eshte nje organ vendimor.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Asambleja e ortakeve vendos per bilancin vjetor, ndryshimet ne statut, emerimin e ekspertit kontabel apo te Komisionit te eksperteve Kontabel , mbylljen e aktivitetit te shoqerise.

Asambleja e ortakeve perbere nga ortakët qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar vendos per ceshtjet e meposhteme :

- **Ndryshime ne statut.**
- **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit fillestar**
- **Ratifikimi i programit vjetor te aktivitetit te shoqerise.**
- **Ndarjen e fitimit nga rezultatet.**
- **Koheshtrirjen e aktivitetit te shoqerise.**

Ne lidhje me ceshtje te tjera Asambleja vendos me shumice votash.

Ne asamblene e ortakeve cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit fillestar qe ai zoteron.

Asambleja e ortakeve do te thirret te pakten nje here ne vit, dhe kjo do te lajmerohet te pakten 30 dite perpara me shkrim.

Neni 9 **Kompetenca te tjera te asamblese se ortakeve**

Asambleja e ortakeve eshte kompetent te marre vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise.

E drejta per te filluar dhe analizuar nje problem ne asamblene e Ortakeve i perket si ortakeve ashtu edhe ndonje perfaqesuesi tjetër nga shoqerise si administratorit, ekspertit kontabel apo shefit te finances, gjithashtu edhe administatoret e degeve.

Kompetenca te tjera eskluzive te Asamblese se ortakeve jane:

- Te percaktoje drejtimet kryesore te aktivitetit te shoqerise.
- Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike pasi ato jane trajtuar nga pikepamja e aktivitetit te shoqerise, ne perputhje me aktivitetin e saj.
- Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin fillestar,
- Percaktimi i regjimit dhe i kushteve per aplikimin e koncepteve te ndryshme te kontabilitetit,
- Perfundimi i rregullave normative qe percaktojne mardheniet brenda shoqerise, duke perfshire te gjithe personelin dhe stafin e shoqerise dhe te degeve te saj .percaktimi i strukturave te administrates se shoqerise.
- Percaktimi i stafit dhe shperndarja e posteve drejtuese nepermjet perfaqesuesve te ortakeve, emerimin dhe shkarkimin e Administratorit te shoqerise, i cili mund te zgjidhet nga radhet e ortakeve ose nga jashte shoqerise.
- Krijimin e organeve te tjera e nevojshme per permbushjen e objektive te shoqerise.
- Percaktimin e sasise e detyrueshme te te nevojshme per krijimin e kapitalit themeltar, krijimin dhe perdorimin e fondeve speciale, ne ndarjen e fitimeve dhe per caktimin e rregullave perpagimin e detyrimeve,
- Te marre vendim per krijimin e degeve dhe perfaqesimin dhe per te ceduar aktivitetin e tyre ne perputhje me marreveshjet e lidhura ndermjet organeve te Republikes se Shqiperise dhe personave te tjere juridike, aty ku do te jene selite e tyre.
- Pergatitja e nje rregulloreje per proceduren e punes se Asamblese se ortakeve,
- Pergatitjen e propozimeve per mbylljen e aktivitetit te shoqerise,
- Zgjedhjen e anetareve per komisionin e likujdimit, te cilet emerohen dhe shkarkohen nga Asambleja e ortakeve,
- Permbushja e veprimeve per likujdimin e llogarive qe iu perkasin ortakut qe jep doreheqjen nga shoqeria,
- Merr vendim per marrjen dhe perdorimin e kredive me afat te gjate,
- Hapjen e letrave te kreditit ne monedhe shqiptare dhe ne monedhe te huaj,

- Lidhja e kontratave te bashkepunimit me te tretet me afaft mbi tre vjet dhe me vlere monetare mbi 10 000 USD,
- Percaktimin e numrit te punonjesve dhe pagat e tyre.

Neni 10

Administratori i Shoqerise

Administratoret e shoqerise administrojne aktivitetin operativ te shoqerise. Ata drejtojnë shoqerine per keto probleme:

- Organizon punen per plotesimin e planeve te shoqerisen dhe raportin per to.
- Ne perputhje me planet dhe programet e pergjitheshme kryen administrimine pasurise se shoqerise ,duke perfshire dhe mjetet financiare brenda kufijve te vendimeve te marra nga Organi Administrativ i Shoqerise drejton dhe kontrollon aktivitetin e degeve dhe misioneve.
- Perfaqeson shoqerine ndaj personave te trete ne Gjykate dhe arbitrazh, nenshkruan marreveshje ne emer dhe per llogari te shoqerise dhe siguron zbatimin e tyre.
- Merr te gjitha vendimet lidhur me keto aktivitete te cilat nuk jane kompetenca eskuzive te Asamblese se ortakeve.
- Raporton dhe eshte pergjegjes para Asamblese se ortakeve per permbushjen e aktivitetit te shoqerise, qe jane competence e tij.

Administratori percaktohet nga asambleja e ortakeve per nje periudhe e cila percaktohet ne kontraten e punesimit.

Ne perputhje me propozimet e ortakeve administratori mund te jete shtetas shqiptar ose i huaj.

Kapitulli III

Neni 11

Financat ,bilanci dhe veprimet financiare te shoqerise

Veprimet financiare te shoqerise pasqyrohen ne librat financiare te shoqerise (Kontabilitetin) duke aplikuar kriteteret dhe dispozitat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar per kontabilitetin e shoqerive tregtare.

Shoqeria disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.

Shoqeria ka te drejten e parablerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve pasurite e shoqerise si garanci-mjet sigurimi per qellime te aktivitetit te saj.

Shoqeria per sigurimin e aktivitetit te saj krijon fondet e saj. Perberja , madhesia, burimet e krijimit, perdorimi e rregulli i cdo fondi e vecante vendoset me vendim te asamblese se ortakeve, duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

Shoqeria disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundeshme gjate veprimtarise se shoqerise do te mbulohen nga fondet perkatese apo nga fondi rezerve, ose me zmadhimin e kapitalit fillestar. Te gjitha pasurite e shoqerise pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Neni 12

Eksperti Kontabel i Shoqerise

Shoqeria fillimisht do te kete nje ekspert kontabel, i cili do te emerohet nga Asambleja e Ortakeve per nje periudhe e cila percaktohet ne kontraten e punesimit.

Kapitulli IV

Mardheniet e punes ne shoqeri

Neni 13

Mardheniet e punes ne shoqeri dhe ne deget e saj do te rregullohen nga kontrata e punes.

Per ceshtje te cilat nuk mund te rregullohen nga Kontratat, do te aplikohen dispozitat e Kodit Shqiptar te Punes.

Kapitulli V

Mbyllja e shoqerise

Neni 14

Aktiviteti i shoqerise eshte per nje priudhe te pacaktuar kohe dhe mund te mbyllet ne rastet kur :

- a) Mbaron afati i parashikuar ne aktin e themelimit.
- b) Nuk mund te realizohet objekti i shoqerise sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit.
- c) Nje vendim te tille e marrin ortaket e shoqerise.
- d) Nese shoqeria nuk rezulton fitimprurese gjate dy viteve te fundit.

Neni 15

Likujdimi i Shoqerise

Likujdimi i shoqerise dote behet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ne castin e likujdimit.

Kur shoqeria kalon ne procedura likujdimi:

- Asambleja e ortakeve cakton komisionin e likujdimit, te cilit i paraqet pasqyrat e bilancit te likujdimit dhe shoqeria mbyll aktivitetin e saj ne momentin kur ky bilanc aprovohet.
- Pasurite qe jane ne zoterim te shoqerise me te drejte perdorimi , i kthehen pronarit. Vlera e perdorimit te kesaj pasurie, llogaritet mbi shumen qe duhet t'i kthehet ortakut i cili eshte nga vendi i vet.

- Mjetet financiare te mbetura nga pagesat e bera per likujdimin e kreditoreve te fituara nga Shoqeria dhe aktiviteti i degeve te saj,do te ndahen ne proporcion me detyrimet e tyre.

Neni 16

Ne rastet kur aktiviteti i degeve mbyllet, per shkak riorganizimi, afatet e mbylljes vendosen nga asambleja e ortakeve.

Likujdimi i degeve do tejete i njejte me ate te shoqerise.

Mjetet financiare te fituara nga aktiviteti i degeve te likujduara,dhe fondet financiare vihen ne dispozicion te shoqerise duke bere filimisht pagesat per likujdimin e kreditoreve.

Neni 17

Dispozita te fundit


Ky statut eshte hartuar ne kater kopje me vlere te barabarte ne gjuhen shqipe.

Per regjistrimin e shoqerise perdoret nje kopje e cila ka perparesi ligjore.

Per sa me sipër ortaket rane dakort dhe nenshkruan.

ORTAKET E SHOQERISE

Ylli Hysenbelliu

Ylli Hysenbelliu


Fecorr Sado

FECORR SADO
